



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

**THIRRJE E JASHTËZAKONSHME PËR PROPOZIME/ APLIKIME NË
ARSIM NË KUADËR TË COVID-19**

Në kuadër të Nismës së Evropës Qendrore (Central European Initiative), Presidenca Hungareze publikon thirrjen e jashtëzakonshme për propozime/ aplikime në kuadër të COVID-19: 600,000 EUR për projekte në fushat e kujdesit shëndetësor, arsim dhe sipërmarrje (**Afati: 9 Prill 2020**).

Nisma e Evropës Qendrore CEI synon të kontribuojë në përballimin e shpërthimit global të COVID-19 në sektorët më të prekshëm sikurse është edhe edukimi. “*Edukimi dhe mësimi elektronik / mësimi në distancë (Education and e-learning/distance learning EDU)*”, konsiderohet si një nga fushat më të rëndësishme në situatën e sotme dhe lidhet me gjetjen e mundësive në arsim: si mësimdhënia në ambiente virtuale lehtësisht të arritshme për nxënësit dhe studentët përmes pajisjeve personale. CEI ofron një ndihmë të vlefshme në tejkalimin e vështirësive logjistike, për shkaqe të ndryshme nga COVID-19.

Për një informacion më të detajuar lutemi referojuni materialeve informues bashkëlidhur ku përfshihet edhe formulari i aplikimit ose adresës në web:

<https://www.cei.int/news/8810/covid-19-extraordinary-call-for-proposals-launched-600000-eur-for-projects-in-field-of-healthcare>

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE

ASISTENCËS